



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.100/2021

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi, kryetar, Shukri Sylejmani dhe Beshir Islami, anëtar, në çështjen juridike të paditësit- propozuesit të masës së sigurimit, G. T. i lindur në ..., tani me vendbanim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës të cili me autorizim e përfaqëson M. E. S. avokate nga ..., ..., kundër të paditurve- kundërshtarëve të masës së sigurimit K. T. nga ..., A. G. nga ..., F. H. nga ... dhe L. B. nga ..., të cilët me autorizim i përfaqëson N. P. avokat nga ..., për shkak të anulimit të kontratës me propozim për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur përkitazi me revizionin e të autorizuarit të paditurve-kundërpropozuesve, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 4795/20, të datës 12.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më 09.08.2021, merr këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet si i palejuar revizioni i të autorizuarit të paditurve-kundër propozuesve, i paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 4795/20, të datës 12.11.2020.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktvendimin C.nr.382/2020, të datës 04.09.2020, në pikën I, të dispozitivit, e ka aprovuar si të bazuar propozimin e propozuesit të masës së sigurimit G. T. nga Prishtina tani me vendbanim në SHBA. Në pikën II, të dispozitivit e ka caktuar masën e sigurimit

për bllokimin e 8 % të aksioneve të shoqërisë aksionare 3, me seli në Prishtinë, rruga, me numër të biznesit ..., me drejtor kundërshtarët e sigurimit K. T., A. G.. F. H. dhe L. B. të gjithë nga ..., dhe ia ka ndaluar shitjen, bartjen, dhurimin apo çdo lloj tjetër tjetërsimi të 8 % të aksioneve të shoqërisë aksionare 3 CIS JSC, deri në zgjidhjen e çështjes meritore të kësaj çështje kontestimore. Në pikën III, të dispozitivit, ka vendosur që vendimin mbi caktimin e masës së sigurimit të ia dërgoi Agjencisë Kosovare për Regjistrim të Bizneseve – Krye shefit Ekzekutiv të Agjencisë. Në pikën e IV, të dispozitivit, ka përcaktuar se procedura do të vazhdohet sipas rregullave të procedurës kontestimore në pajtim me planin e punës së gjykatës.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 4795/20, të datës 12.11.2020, është refuzuar e pa bazuar ankesa e palës së paditur dhe është vërtetuar aktvendimi i lartcekur i gjykatës së shkallës së parë.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, pala e paditur ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe të parë, të anulohen dhe çështja ti kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Pala paditëse nuk ka parashtruar përgjigje në revizion.

Pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur sipas nenit 230 lidhur me nenin 215 të LPK, gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se:

Revizioni është i pa lejuar.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi me kërkesë për anulim të kontratës, dhe me propozim për caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktvendimin C.nr.382/2020, të datës 04.09.2020, ka vendosur të aprovohet si i bazuar propozimi i paditësit – propozuesit për caktimin e masës sigurisë, ndërsa me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 4795/20, të datës 12.11.2020, është refuzuar e pa bazuar ankesa e palës së paditur, siç është përshkruar më lartë.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë ka paraqitur revizion pala e paditur, andaj Gjykata Supreme e Kosovës, duke vlerësuar të njëjtin ka ardhur në përfundim se i njëjti është i pa lejueshëm, pasi me dispozitën e nenit 228 paragraf 1, të LPK-së, përcaktohet se: “Palët mund të

paraqesin revizion kundër aktvendimeve të formës së prerë me të cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallë së dytë”, ndërsa në paragrafin 2, të nenit të njëjtë përcaktohet se: “Nuk lejohet revizioni kundër aktvendimeve nga paragrafi 1 i këtij neni në konteste në të cilat nuk do të ishte i lejuar revizioni”.

Duke marrë parasysh këtë dispozitë, revizioni nuk lejohet kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 4795/20, të datës 12.11.2020, pasi kemi të bëjmë me aktvendim me të cilin është vendosur për caktimin e masës së sigurisë, dhe ky lloj i aktvendimit nuk është vendim përfundimtar, që do me thënë se është aktvendim me karakter të përkohshëm, dhe me pushimin e rrethanave për të cilat është caktuar i njëjti mund të ndryshohet.

Pasi që gjykata e shkallës së parë nuk e ka hedhur revizionin e të autorizuarit të paditurve-kundërpropozuesve, si të palejuar, siç parashihet me nenin 218 të LPK-së, atëherë Gjykata Supreme të njëjtin e hedhë si të palejuar e në bazë të nenit 221, lidhur me nenin 230 të LPK-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
Rev.nr.100/2021, më 09.08.2021

Kryetari i kolegjit, gjyqtari
Fejzullah Rexhepi